

VANGJEL TOÇI

TË DHËNA MBI ONOMASTIKËN ILIRE NË DYRRAH DHE NË QENDRA  
TË TJERA TË VENDIT TONË

Në studimin e gjuhës, të jetës dhe të kulturës materiale e shpirtërore të ilirëve një rëndësi të veçantë ka edhe onomastika e tyre. Kërkimet në këtë fushë dhe në lëmin gjuhësor e historik përgjithësisht i kanë çuar kohët e fundit disa autorë në përfundime të reja rreth prejardhjes dhe shtrirjes territoriale të ilirëve.

Sipas H. Krahes, emri i ilirëve ka dalë prej një celule embrionale dhe i përkiste një populli të veçantë në pjesën qendrore të bregdetit adriatik, aty rreth zonës së lumit Drilon<sup>1</sup>. Emri u përhap pastaj në shumë popuj gjersa Ἰλλυριοί u përdor për të cilësuar një popull të madh të përbërë nga shumë të tjerë që kishin lidhje fisi e gjuhe në mes të tyre. Njoftimet e para të Hekateut dhe pastaj ato të Herodotit, lënë të kuptohet se emri i ilirëve erdhi duke u bërë i njohur në fillim nga lindja, në viset e brendshme të Ballkanit, dhe më vonë drejt veriut, gjatë bregdetit adriatik. Dalëngadalë, me kalimin e shekujve, ai erdhi e u përhap në një hapësirë të konsiderueshme duke përmblodhur një numër fisheshe me afërsi të dallueshme etnike. Më vonë, në kohën e pushtimit romak, e humbi kuptimin e parë dhe u shndërrua më tepër në një koncept politiko-administrativ: në provincën Illyricum u futën krahina e popuj të tjerë, gjersa zgjerimi arriti kulmin nën sundimin e Dioklecianit, kur prefektura me të njëjtin emër përfshinte pothuaj tërë gadishullin e Ballkanit, pa Trakinë Lindore<sup>2</sup>. Ndryshime ndodhën pastaj me prishjen e perandorisë. Termi *Illyricum* erdhi duke rënë derisa perëndoi.

Interesimi për gjuhën dhe popullin e ilirëve u bë gjithnjë më i madh në kohën e re me anë të një sërë punimesh të rëndësishme nga J. Tunman, P. Kreçmer, G. Majer, N. Jokl, F. Ribeco, J. Uotmou etj. Pas botimit të dy fjalorëve: «Die alten balkanillyrischen geographischen Namen» dhe «Lexikon altillyrischer Personennamen» nga H. Krahe, duke u mbështetur në zbulimet e reja epigrafike dhe në metodën e krahasimit, termi ilirishte u shtri tepër<sup>3</sup>. Ilirët filluan të cilësohen si bartës të së quajturës kulturë të urnave dhe shtrirja e tyre tokësore u zgjerua aq shumë, sa kaloi në një pjesë të mirë të Italisë dhe në Gjermani, Francë, Spanjë e gjer në Britani. Ndërkaq, kur nga zbulimet mbishkrimore dhe studimet rezultoi se venetishtja e Italisë së Veriut ishte një gjuhë me vete dhe se venetët e Italisë nuk duheshin ngatërruar me ata të Ilirisë, që Herodoti (I, 196, 1) i përmend

1) H. Krahe, *Sprache der Illyrier*, I, Wiesbaden, 1955, f. 3.

2) H. Krahe, *vep, e cit.*, f. 4.

3) H. Krahe, *Vom Illyrischen zum Alteuropäischen*. «Indogermanische Forschungen» LXIX/3, Berlin 1964-65. Me vdekjen e autorit më 26.6.1965 vepra konsiderohet si testamenti i tij shkencor.

si Ἰλλυριῶν Ἑνετοί nisi sulmi kundër «panilirizmit». Duke studjuar ndërkohë hidroniminë e Evropës, H. Krahe arriti një tjetër shtresë gjuhësore të përbashkët për vendet e kontinentit: paleoevropianishten.

Përfundimet e mësipërme kanë sjellë pra si rrjedhim kohët e fundit lëkundjen e teorisë tradicionale të një gjuhe unitare ilire të folur përafërsisht në territorin e përfshirë midis dialekteve kelte të luginës së lumit Po dhe maqedonishtes dhe të shtrirë nga lindja deri në Danub. Ato kanë ndikuar në shfaqjen e mendimeve të reja mbi disa fise ilire, sidomos mbi venetët dhe fiset në veriperëndim të Gadishullit ballkanik, lidhur me të folurën e tyre si njësi gjuhësore të mbyllur dhe veçori të tjera dalluese<sup>4</sup>. Këto konkluzione, nga ana tjetër, kanë lindur dhe nevojën e dallimit të disa zonave gjuhësore si dhe përcaktimin e lidhjeve të këtyre brenda trevës ilire. Është për këtë arësye pra, që në dritën e këtij deduksioni një interesim i posaçëm po tregohet kohët e fundit për territorin e Ilirisë së jugut të quajtur nga Plini (N.H. III, 144) e Pompon Nela (II, 55) si Iliria e vërtetë (Illyrii proprie dicti), pasi në këtë territor, ku ndodhet pikërisht dhe Shqipëria, mendohet të jetë folur ajo gjuhë që do cilësuar para gjithë dialekteve të tjera si gjuhë ilire<sup>5</sup>.

Ky vlerësim ka për ne një rëndësi të veçantë, prandaj në këtë vështrim do t'i shohim dhe emrat vetiakë ilirë, që këto vite i kemi gjetur në dokumentat mbishkrimore të vendit tonë, sidomos në ata të nekropolit të Dyrrahit. Në këtë varrezë të lashtë dhe në po atë zonë ku më 1958-62 doli një grup emrash të botuar prej nesh<sup>6</sup> janë zbuluar që nga viti 1962 e këtej një tok mbishkrimesh të tjera të gdhendura mbi gurë varresh. Në mes tyre kanë vlerë kryesisht ato që po i japim tani për herë të parë. Mbishkrimet janë skalitur gati të gjitha mbi shtyllëza të rrumbullakta prej guri gëlqeror, të mbështetura ose jo mbi bazamente katërkëndëshe: vetëm dy prej tyre janë gdhendur njëri mbi një bust (Nr. 17) dhe tjetri mbi një kapak (Nr. 6). Po i radhitim si më poshtë:

#### a) Krahu jugor i brezit të kodrave të T. Kokomanit:

##### 1. Shtyllëz e Epikadit të Epikadit

Është gjetur tok me tri shtyllëza të tjera dhe një arkëz hiri në shpatin pranë majës 75 m. të lartë. Shtyllëza është me bazament, e

4) Shiko H. Krahe, *Vorgeschichtliche Sprachbeziehungen von den baltischen Ostseeländern bis zu den Gebieten um den Nordteil der Adria*, Abhandlungen der Akademie Mainz, 1957, Nr. 3, f. 101-121; *Das Venetische, seine Stellung im Kreise der verwandten Sprachen*, S.B. Heidelberg 1950; *Sprache und Vorzeit*, Heidelberg 1954, f. 114-122; *Vom illyrischen zum Alteuropäischen* «Indogermanische Forschungen», LXIX/3, Berlin 1964-65; C. de Simone, *Osservazioni sull'onomastica della nekropoli di Durazzo*, «Beiträge zur Namenforschung» Jahrgang 14 (1963), Heidelberg f. 124; *Kratylos* 7 (1962) f. 126 e vijim; J. Untermann, *Die Venetischen Personennamen*, Wiesbaden, 1951; D. Rendić-Miočević, *Onomastičke studije za teritorije Liburna* «Zbornik Instituta za historijski nauke u Zadru», Zadar 1955, f. 125-141; R. Katičić, *Die Illyrischen Personennamen in ihrem südöstlichen Verbreitungsgebiet* «Ziva antika» 12, Skoplje, 1962, f. 95.

5) Shih dhe C. de Simone, *Osservazione sull'onomastica della nekropoli di Durazzo*, «Beiträge zur Namenforschung» Jahrgang 14 (1963), Heidelberg, f. 125; R. Katičić, *Po aty*, f. 95.

6) V. Toçi, *Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahit*, «Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës — Seria shkencat shoqërore», Nr. 2, 1962, f. 70-132. *Inscriptions et reliefs de la nécropole de Dyrrah (Dyrrhachium)*, «Studia Albanica» Nr. 2, 1965, Tiranë p. 49-99.

lartë 0,485 m. Afër kreut ka këtë mbishkrim të dëmtuar në dy radhët e para:

ΕΠΙ[ΚΑΔ]ΟC  
ΕΠΙΚΑ[ΔΟ]Υ  
ΧΑΙΡΕ

2. Shtyllëz e Antis të Epikadit

Është e prerë pjerrtas në kokë, duke cinguar dhe mbishkrimin, pa lënduar kuptimin e fjalëve.

Rreth e qark trupit të saj, afër majës, është thadruar një brez me tokëz përpara, nën të cilin vjen mbishkrimi:

ΑΝΤ[ΙC]  
ΕΠΙΚ[ΑΔΟ]Υ  
ΧΑΙΡΕ

Shtyllëza është e lartë 0,575 m.

3. Shtyllëz e Iraklidës së Epikadit.

Bashkë me dy të parat është gjetur pranë shtyllëzës së katërt që ka mbishkrimin Κλέα Ηρακλειδα καίρε. Shtyllëza, e lartë 0,58 m, është hijeshuar në krye me një kurorë lari të skalitur rreth trupit të saj. Mbishkrimi triradhësh që duket nën këtë kurorë është:

ΗΡΑΚΛΕΙΔΑC  
ΕΠΙΚΑΔΟΥ  
ΧΑΙΡΕ

Në largësi 18 m, në jug të vendit të këtyre katër shtyllëzave dhe 7 m. nga veriu, pranë shtëpisë së T. Kokomanit, u zbuluan afër njëra-tjetrës tri shtyllëza të tjera në mes të të cilave:

4. Shtyllëza e Dazait të Apollonit

Kjo, e lartë 0,38 m, ka një mbështetëse të rregullt dhe është e gërvishur pak në të majtë të mbishkrimit, që është edhe ky prej tri rradhësh:

ΔΑΖΑΙΟC  
ΑΠΟΛΛΩΝΙΟΥ  
ΧΑΙΡΕ

5. Shtyllëz e Antis të Epikadit

Poshtë shtëpisë së T. Kokomanit, në rrugicën që zbret para saj, u gjend një kionisk, që ka qenë nxjerrë nga një pllakë e punuar. Ana e

sipërme e këtij, në trajtë shtyllëze, me prerje pothuaj vezore, përfundon me një bazament jo të rregullt katërkëndësh. Në ballë ka këtë mbishkrim të sajuar nga shkronja me apices:

ΔNTIC  
ΕΗΙΚΙΔΔΟΥ  
ΧΔΙΕ

Shtyllëza, e thyer në dy copë, është e lartë 0,26 m.

6. *Arkëz e Tatës së Laidit*

16 m. më nga jugu i vendit ku u gjet shtyllëza e sipërme, në fillim të rrugëzës që të shpie te shtëpia e personit të përmendur, u zbulua një arkëz hiri tok me një grup shtyllëzash, që kanë lidhje me familien e Truferës, Getës e Melanhit. Arkëza katërkëndëshe është në gjëndje të mirë, kurse mbulesa pak e dëmtuar në një cep. Kapaku me kulm (i gjatë 0,40 m. i gjërë 0,30 m dhe i trashë 0,05 m), ka në njërin faqe këtë mbishkrim të gdhendur dobët:

ΤΑΤΑ  
ΔΔΙΑΙΑ

7. *Shtyllëz e Nausen Sihut*

Është gjetur me shtyllëzat e përmendura më lart. Kionisku vjen i hollë e i gjatë si në shtyllëz, ashtu dhe në mbështetësen e tij, që është e sheshtë vetëm në faqen përpara. Dy bisqe lari të skalitur në relief, gërshetohen kurorë rreth ballit. Nën këtë kurorë është mbishkrimi dyradhësh:

ΝΑΥϞΗΝ CYXOY  
ΧΔΙΕ

Lartësia e gurit është 0,60 m.

8. *Shtyllëz e Dazit të Aristeut*

Shtyllëza është gjetur jo larg të tjerave. Ka ruajtur këtë mbishkrim të fshirë në fillim të radhës së parë e të tretë:

ΔΔ ΙΖΙΟC  
ΔΠΙCΤΕΔ  
ΧΙΔΙΕ

Është e mangët dhe ka mbetur e lartë vetëm 0,15 m.

Ngjitur me kodrinën e lartë 75 m, në faqen pak të pjerrët të shpatit që pason tutje nga perëndimi, dolën dy gurë të tjerë varresh. Këta janë:

9. *Shtyllëza e Adistës së Dazit*

E lartë 0,34 m, me mbështetëse jo të rregullt, kjo shtyllëzë ka këtë mbishkrim triradhësh:

ΔΔΙCΤΔ  
ΔΔΖΙΟΥ  
ΧΔΙΕ

10. *Shtyllëza e Filumenës së Laidonit*

Është pa bazament dhe ka një lartësi prej 0,22 m. Mbishkrimi është ky.

ΦΙΛΟΥΜΕΝΑ  
ΛΑΙΔΩΝΟΣ  
ΧΑΙΡΕ

11. *Shtyllëz e Brsikut*

Është gjetur në anën më perëndimore të brezit të kodrave T. Kokomanit. Nga shtyllëza ka mbetur vetëm pjesa e sipërme dhe kjo e këputur pjerrtas nga e majta në të djathtë, duke lënë këtë mbishkrim të cunguar:

ΒΡΕΥΚΟC  
...ΙΩΝΟC

Pjesa e ruajtur është 0,09 m e lartë.

b) **Krahu verior i brezit të kodrave të Dautes:**

Ky sektor i nekropolit ka dhënë herë pas here një numër mbishkrimesh varresh:

12. *Shtyllëz e Filistidës së Titit*

Është gjetur në majën më perëndimore të brezit të kodrave, mbi Currilat. Shtyllëza me mbështetëse ka qenë nxjerrë nga një punim në gur. Mbishkrimi i saj është:

ΦΙΛΙCΤΙΑΔΑC  
ΤΙΤΟΥ  
ΧΑΙΡΕ

Lartësia 0,495 m.

13. *Shtyllëz e Filotës së Laidit*

Kjo shtyllëz e vogël, e lartë 0,225 m i përket një fëmije, qëndron mbi bazament të rregullt dhe ka këtë mbishkrim:

ΦΙΛΩΤΑC  
ΛΑΙΔΙΑ  
ΧΑΙΡΕ

U gjet në shpatin e kodrës 72 m të lartë.

14. *Shtyllëz e Andenës*

U zbulua po në atë shpat, është e rregullt, por skalitja e shkronjave të saj është pak e shkuajdesur. Ka këtë mbishkrim:

ΑΝΔΗΝΑ  
ΧΑΙΡΕ

Është 0,345 m e lartë.

15. *Shtyllëz e fëmijës së Platorit*

Është e lartë 0,14 m dhe është gjetur në faqen verilindore të kodrës së Dautës me kuotë 72 m. Shtyllëzës së vogël i mungon mbështetësja; ajo ka prerje vezore dhe këtë mbishkrim të cunguar në radhën e parë:

Ζω[ΠΥΡΟC ?  
ΠΛΑΤΟ[Ρ]ΟC  
ΧΑΙΡΕ

16. *Shtyllëz e Zaiminës*

Është zbuluar në shpatin e kodrës së lartë 72 m në skajin lindor; bazamenti i saj nuk është i rrafshët dhe vjen pak më i hollë nga fundi. E lartë 0,57 m, ka këtë mbishkrim:

ΖΑΙΜΙΝΑ  
ΧΑΙΡΕ

c) *Në pika të ndryshme të qytetit:*

Janë gjetur katër gurë funerarë që vijnë nga nekropoli.

17. *Bust i Kleitës së Lysandrit*

Është nxjerrë nga muri i një shtëpie, ku ish vënë për zbukurim, në rrugën «Dalip Tabaku», 78 m në veri të pallatit të kulturës «A. Moisiu».

Busti paraqet portretin e një gruaje me fytyrë vezore e shikim të ngulur para (fig. 17/a, 17/b). Kjo ka vënë mbi kokë një vello dhe është stolisur nga një palë vathë të gjatë dhe një gjerdan rruazash rreth qafës. Shtatin femra e ka veshur me një këmishë të brendshme, sipër me një rrobë tjetër më të trashë a jelek me grykë të hapur si katror, që i lë të duket buza e veshjes së parë.

Mbishkrimi që ndjek poshtë figurën është mjaft i fshirë dhe përbëhet nga këto tri radhë:

ΚΛΕΙΤΙΑ  
ΛΥCΑΝΔΡΟΥ  
ΧΑΙΡΕ

Busti është i lartë 0,34 m.

18. *Shtyllëz e Surës së Kerdonit*

Është gjetur me rastin e hapjes së themeleve për ndërtimin e një godine pesëkatëshe 190 m larg nga lindja ku ndodhet mozaiku me fytyrë monumentale gruaje. Shtyllëza është e lartë 0,255 m, pa mbështetëse. Në ballë ka këtë mbishkrim:

СΥΡΑ  
ΚΕΡΔΩΝΟC  
ΧΑΙΡΕ

## 19. Shtyllëz e Teutajes së Nikomahut

Kjo shtyllëz, e vetmja e punuar me mermer, u gjend në oborrin e një shtëpie, 38 m në perëndim të pusit me katër shtylla. Është e lartë 0,47 m, përfundon me majë dhe ka këtë mbishkrim:

ΤΙΕΥΤΑΙΑ  
ΝΙΚΟΜΑΧΟΥ  
ΧΑΙΡΕ

## 20. Shtyllëz e Gentit të Neikulit

Është e lartë 0,22 m, pa bazament dhe e dëmtuar sidomos prapa. Ajo u nxuar nga muri i kullës J, të kalasë së qytetit, ka këtë mbishkrim:

ΓΕΝΘΙΟC  
ΝΙΚΥΑΟΥ  
ΧΑΙΡΕ

Dokumentat e mësipërm mbishkrimorë i përkasin një kohe në mes të shekujve III-I para erës sonë. Këtë e faktojnë tipi i shkronjës Σ në trajtë gjysmë hënëze (C), i E-së së rrumbullakuar (Ε) dhe i A-së me vijën horizontale këndore (Α); gjithashtu dhe formula e pandarë e përshëndetjes χαίρε është karakteristike për këtë kohë.

Sikurse e vërejmë, të gjitha mbishkrimet kur janë dyradhëshe, përveç formulës së përshëndetjes, përbëhen nga emri i personit dhe emri i babait në gjindore. Kjo formulë e përhapur gjerësisht në botën helene është e mundur të ketë përkuar me formulën onomastike vendase<sup>7</sup>. Le të shqyrtojmë tani emrat që interesojnë temën e punimit tonë:

Ανδωνα emër i panjohur gjer tani në vendin tonë. Një emër të tillë e gjejmë në Daki, në Sarmisegetusa (Ael(iae) Andenae, CIL III 1488)<sup>8</sup>.

Αντις, edhe ky emër haset për herë të parë te ne. Ka mundësi t'i përgjigjet trajtës Andis që del në Veneti<sup>9</sup>, por atje është emër burri, kurse ky i nekropolit tonë i përket një gruaje. Këtë e vërteton tërthorazi dhe inventari i arkëzës së përbashkët të hirit që duket se i përket asaj dhe ndoshta vëllait të saj, Iraklidit të Epikadit. Materiali përbëhet ndër të tjera nga stoli prej ari, në mes të të cilave një palë vathë që shëmbëlajnë mjaft me ato të grave mirditore. Për origjinën ilire të kësaj gruaje si edhe të një tjetre po me këtë emër (shih shtyllëzën Nr. 5) të bind dhe fakti se emrat e tyre i shohim që të dy të shoqëruar nga patronimi Επιχαδος.

Βρσυχος, ky emër del për herë të parë dhe, me sa dimë, nuk njihet në vende të tjera. Ndoshta për gabim të gdhendësit, në mes të dy gërmave të para apo në mes të dytës e të tretës është harruar një zanore. Atëhere në rastin e dytë mund të mendojmë që emri të ketë lidhje me brysakët, banorë të një qyteti të fisit ilir të parthinëve<sup>10</sup>. Për origjinën ilire të emrit flet edhe elementi συχος. Mundet që Βρσυχος të jetë edhe emër epikorik.

7) Përsa i përket pastaj formulës onomastike në kohën e pushtimit romak shiko: D. Rendić-Miočević, *Illyrica, zum Problem der illyrischen Formel in römischer Zeit*, «Archäologia Jugoslavica» II, Beograd 1956.

8) H. Krahe, *Lexikon Altillyrischer Personennamen*, Heidelberg, 1929, f. 6.

9) H. Krahe, *vep. e cit.* f. 6.

10) Stephanus Byzantius, *De urbibus et populis (Ethnica)* s.v. Brysekion, Brysakoi.

Γενθιος, emër i njohur ilir. Kështu quhej mbreti i fundit i ardianëve që sundoi rreth viteve 197-168 para erës së re, mbretërinë e të cilit e pushtuan romakët.

Në Shqipëri efigjien dhe emrin e këtij prijësi e mbajnë monedhat e qyteteve Skodra e Lis<sup>11</sup>.

Në Dyrrah ka ekzistuar dhe një ilir me të njëjtin emër: ky kishte detyrën e lartë të nëpunësit të ngarkuar për organizimin dhe prerjen e monedhave, sikurse del nga një drahme argjendi e qytetit, vënë në qarkullim aty në mes të shekujve IV-I para erës sonë<sup>12</sup>.

Emra analogë ndeshen edhe në zonën e liqenit të Ohrit. Këtu dëshmohet një Μαχάτας Γενθιου nga Struga pranë Lyknidit<sup>13</sup> një Γενθιος pronar poçerie, që ka bërë të vuloset emri i tij në një grykë pitosi<sup>14</sup> dhe një Γενθιανος të cilin e lexojmë bashkë me tre emra ilirësh të tjerë në një gur varri nga Verri-Slatina e Mokrës<sup>15</sup>. Në Buthrot përmendet dhe një Γενθιος skllav i liruar.

Nga mbishkrimet latine marrim vesh, nga ana tjetër, se qytetarë të quajtur Gentius, jetonin dhe jashtë kufijve të vendit tonë në Naronë të Dalmatisë dhe më tej akoma jashtë zonës ilire: një në Delfi të Greqisë dhe të tjerë në qytete të Italisë.

Δαζαιος, del për herë të dytë në Durrës. Radhën e parë ka dalë në një pllakë varri të pjesës jugperëndimore të nekropolit.

Δαζιος është një emër me të njohur ilirë. Me variantet dhe derivatet e shumtë Δασζος, Δαζαιος, Δαζος, Δαζιουος, Δαζιπος, Dasas, Dasant-Dasantilla, Dases, Das(s)ius, Dastidius, Dasto, Daza, Dazanus etj. e gjejmë të përhapur në shumë vende: në Dalmati, Panoni, Daki; në Italinë e Jugut, kryesisht në Kalabri, me kuptimin e vjetër të fjalës figuron te mesapët në mjaft mbishkrime të tyre<sup>17</sup>.

11) S. Islami, *Premjet monetare të Skodrës, Lisit dhe Gentit*, «Studime historike» Nr. 3, 1966, f. 20-22.

12) H. Ceka, *Probleme të numizmatikës ilire*, Tiranë, 1965, f. 131.

13) H. Krahe, *Vep. e cit.*, f. 54.

14) Gjetur në Selcë të poshtme të Mokrës. Gryka e enës ruhet në muzeun e Pogradecit.

15) Mbishkrimi nuk është i plotë: nga ai kanë mbetur vetëm këto radhë me këtë përmbajtje:

Λ Δ Ζ Ε Ι Ω Ν Ο Σ  
Κ Λ Ε Ι Τ Ο Υ Ε Τ Ω Ν Κ Ε  
Γ Ε Ν Θ Ι Α Ν Ο Σ Π Λ Δ  
Τ Ο Ρ Ο Σ Κ Λ Α Τ Α Δ Ι Χ Ο Η  
Ι Ο Η Π Ι Χ Φ . . .

16) K. Bozhori — Dh. Budina, *Disa mbishkrime të pabotuara të theatrit të Βατριντit*, «Studime historike» Nr. 2, 1966, f. 173.

17) H. Krahe, *Die Sprache der Illyrier*, I, Wiesbaden 1955 f. 12-37; C. de Simone, *Die messapischen Inschriften* në H. Krahe, *Die Sprache der Illyrier* II, Wiesbaden 1964, ff. 55, 60, 69, 71, 84, 85, 88, 92, 103, 109, 114, 118, 131-132; J. Untermann, *Die Messapischen Personennamen*, po aty, f. 162-200.

Nga veprat e tjera të mëparshme që trajtojnë gjuhën mesape dhe veçanërisht emrat e personave, që përbëjnë pasurinë më të çmuar të mbishkrimeve mesapishte, janë për t'u përmendur një varg i tërë në mes të të cilave simbas kronologjisë: Th. Mommsen, *Die unteritalischen Dialekte*, Leipzig, 1850; J. Whatmough, *The prae Italic Dialects of Italy II* London — Cambridge (USA) 1933; F. Ribezzo, *Corpus inscriptionum Messapicarum*, «Revista Indo-Greco-Italica» 6 (1922), 7, 9, 10, 16, 19, (1935); V. Pisani, *Le lingue dell'Italia antica oltre il latino*, Torino 1953; Studia in honorem Acad. D. Dečev, Sofia 1958; O. Parlangeli, *Le iscrizioni messapiche*, Messina 1960; *Studi messapici*, Milano 1960.

Në Dyrrah Δαζιος është quajtur dhe një tjetër nëpunës i ngarkuar për prerjen e monedhave (shih dhe f. 183).

Emri është i afërt me Λαζιος<sup>18)</sup> dhe ky me origjinë ilire, të cilin e kemi gjetur në një shtyllëz varri (Γάειε Λαζιε Επανης χαϊρε) po në atë anë të varrezës së lashtë që përmendëm më parë.

Επικαδος emër i njohur ilir me gjithë tingëllimin grek për shkak të parashtesës επι-. Origjinën e tij ilire, H. Krahe, ka kohë që e ka provuar kundër A. Majerit dhe P. Skokut<sup>19)</sup>. Sipas I. I. Russut elementi -cadus, ka shumë të ngjarë të ketë të bëjë me indoeurp. \*q<sup>u</sup> ed; nxis, përforcoj, shpejtoj, i shpejtë, i guximshëm<sup>20)</sup>.

Historikisht prej Tit Livit mësojmë se aty nga viti 168 para erës së re, një nga dy miqtë (shokët) e ilirit Plator, vëllait të Gentit, quhej Epikad, sikurse quhej dhe një prijës i ilirëve parthinë që banonin në afërsi të Dyrrahit. (Liv. XLIV 30, 3; XLIV, 30, 13).

Nga të dhënat mbishkrimore latine del se emri Epicadus ka qenë mjaft i përhapur në Dalmati, Daki dhe Itali, por në trajtën Επικαδος atë e shohim gjer tani pothuaj vetëm në Shqipëri: në Apolloni, në dy drahme argjendi dhe në një vulë tjegulle, në Kozarë të Beratit, pranë liqenit të Lyknidit, në Pogradec<sup>21)</sup> dhe në Butrint.

Në Durrës Επικαδος duket se ka qenë një ndër emrat vetjakë më të njohur ilirë, pasi këtu, nga gurët e varreve të nekropolit, mësojmë se brenda një kohe të shkurtër, shtatë qytetarë mbanin këtë emër. Për më tepër në Dyrrah ka jetuar një familje e tërë me mbiemrin Epikad. Sikurse e tregojnë të katër shtyllëzat e gjetura tok (nr. 1, 2, 3 dhe një e pabotuar) në verën e vitit 1966 në vareznë e lashtë, kjo familje kishte për kryetar një Epikad që ishte bir i një tjetër Epikadi, dhe përbëhej prej gruas së tij helene ose të helenizuar nga emri, djalit dhe vajzës. Ky është një rast shumë i mirë, pasi është hera e parë që hasim në emra familjesh ilire në Durrës dhe në mbarë vendin tonë. Nga ana tjetër, ky zbulim mund të ndikojë dhe në lokalizimin e emrit Epikad brenda kufijve të Shqipërisë (shih më tutje në f. 183).

Επικαδος, variant i emrit të sipërm; del për herë të parë.

Ζαίμνα, tingëllon hijshëm tek ne dhe del për herë të parë. Elementi za- zai-, që mund të veçojmë, është i përbashkët në emrat ilirë të Dalmatisë Zaca, Zaiio, Zanatis dhe në emrat mesapë Zairikes, Zaristhes<sup>22)</sup>.

Λαιδιας, del për herë të parë në vendin tonë, me këtë grafi nuk njohim shembuj të tjerë. Trajtat Laid(i)us<sup>23)</sup>, Laedio<sup>24)</sup>, Laidies<sup>25)</sup>, i gjejmë në Dalmati, Laedio prap në Veneti dhe Laedihi në Mesapi<sup>26)</sup>. Sipas emër-

18) Pape-Benseler, *Wörterbuch der griechischen Eigennamen*, Braunschweig 1911 f. 264/1. Krahaso të Krahe: Laso, Lasinius etj.

19) H. Krahe, *vep. e cit.*, f. 155-156.

20) I. I. Russu, *Studi Ilirice, Partea A III-A; Pozitia Lingvistica a Ilirilor*, «Cercetări de lingvistică» Cluj III, 1958, f. 96. H. Krahe, *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen*, Heidelberg, 1925, f. 22.

21) Emri lexohet në vulën e një gryke pitosi, gjetur kohët e fundit në Pogradec me këtë grafi: Ερικαδος. Ruhet në Muzeun e qytetit.

22) H. Krahe, *Lexikon Altillyrischer Personennamen*, f. 131; Heidelberg 1929 I. I. Russu, *vep. e cit.* f. 97.

23) CIL III D VI — S. D. VII.

24) Glasnik III 1948; 168.

25) Bulletin d'archéologie et d'histoire dalmate, Split (Salona) LIII.

26) C. de Simone, *vep. e cit.* f. 90 (Nr. 139), f. 106 (Nr. 190); J. Untermann *vep. e cit.* po aty. 214.

timit mesapisht — *po-laidehias* kuptim i emrit do të ishte, duke e krahasuar me mbiemrin lituanisht, *pa-laïdas*, «i zgjidhur, i lirë»<sup>27</sup>.

Emri i përbërë Scerdilaedus = *Σκερδιλαιδας* u përket dy figurave historike, atit të Pleuratit, prijës i ardianëve (rreth viteve 210-200 para erës sonë) dhe birit të mbretit Gent (viti 168 para erës së re).

*Λαιδων*, një variant i emrit të sipërm që duket dhe ky për herë të parë.

*Πλατωρ*, njihet dhe dy herë të tjera në Durrës: një nga Ciceroni (Orationes in Pisonem 83) dhe tjetri nga një mbishkrim greqisht: *Ισθηνα Πλατορος χαϊρε*<sup>28</sup>. Emri duket se ishte i preferuar si në shtresat e parisë ashtu dhe në ato qytetare, pasi kështu quheshin disa prijës ilirë dhe një numur banorësh të Dalmatisë, Dakisë e Mesapisë<sup>29</sup> (shiko dhe f. 183).

*Συρα*, bashkë me gjininë mashkullore dëshmohet në Dalmati, Daki, Mezi, Panoni, Istrië dhe në Itali të Veriut. Për shkak të kësaj shtrirjeje gjeografike, H. Krahe, A. Majer, K. de Simone, vërejnë se është e vështirë të caktohet prejardhja e këtij emri<sup>30</sup>. Në Durrës emri po zbulohet për të tretën herë. (Shih dhe më tujte në f. 184).

*Κλειτια* femërore e *Κλειτος*, të cilin, sikur e përmendëm në shënimin 15, e kemi gjetur në një gur varri nga Veri Slatina tok me emrat e tjerë ilirë *Λαζειωνος*, *Γενθιανος* e *Πλατωρ*. Një tjetër element bindës për origjinën ilire të emrit është dhe veshja e gruas Kleitia, bijës së Lysandrit (Nr. 17), veshje kjo karakteristike për gratë ilire të krahinave bregdetare të vendit tonë<sup>31</sup>.

*Συχος*, shembëllën me *Συκος*. Trajtën Sicu e gjejmë në pak raste në Dalmati e Maqedoni. Shih edhe *βροσυκος*.

*Τατα*, e pamë të shoqëruar nga një tjetër emër ilir: *Λαιδιας*. Në nekropol kemi gjetur një tjetër *Τατα* si dhe trajtën *Ταταια*<sup>32</sup>. Dhe jashtë Durrësit, në veri të vendit, këtë emër e ndeshim në një mbishkrim latin të Kolesjanit të Kukësit, ndërsa në Shkodër shohim një *Τατο* (?) te legjenda e një monete të qytetit<sup>33</sup>. Emrat Tata, Tatta, Tattaia, Tato janë të njohur dhe në Dalmati, Daki e Norik.

*Τευταια* një variant i emrit Teuta që duket se është trajta e shkurtrë e Teutana, sikurse përmendet edhe te Flori (Epitom. I, 21, II, 5). Sipas E. Norden, H. Krahe, Xh. Devoto, K. de Simone, emri është një derivat i \**teutá-* «komunitet, popull» i barabartë me gotishten Diudans «mbret»<sup>34</sup>. Në vështirim të këtij termi kuptohet pra në një farë mase dhe lidhja që ka emri me figurat udhëheqëse ilire. Kështu Teuta(na) quhej mbretëresha që luftoi kundër romakëve nga mbarimi i shek. III para erës së re; Triteuta ishte e ëma e mbretit Pinnes (fundit i shek. III para erës sonë); Teuticus quhej legati i mbretit Genthius (168 para erës sonë). Nga ana

27) H. Krahe, *Die Sprache der Illyrier* I, Wiesbaden 1955 f. 59.

28) Supplementum Epigraphicum Graecum, 1923, I, nr. 256.

29) H. Krahe, *Altilyr, Person*, f. 93-94; C. de Simone *vep. cit.* Nr. 69, 104, 114, 121, 134 a, 146.

30) H. Krahe, *vep e cit.* f. 108-109, A. Mayer, *Die Sprache der Alten Illyrier* I, Wien 1957, f. 326; C. de Simone, *Osservazioni sull'onomastica della nekropoli di Durazzo*, cit. f. 128.

31) P. C. Sestieri, *Për historinë e veshjes së vjetër të grave iliriane — Per la storia dell'antico costume femminile illirico*, Tiranë 1943.

32) V. Toçi, *po aty*, f. 92.

33) S. Islami, *po atp*, f. 29.

34) E. Norden, *Alt-Germanien*, Leipzig — Berlin 1934, f. 284-293; H. Krahe, *Sprachverwandschaft im alten Europa*, Heidelberg, 1951, f. 27-28; *Sprache und Vorzeit* f. 65, 67; G. Devoto, *Origini indeoeuropee*, Firenze 1962; f. 310-320; C. de Simone, *vep. e cit.* f. 128.

tjetër prej burimeve të fundit mbishkrimore kuptojmë se emri ka qenë i përdorur në shtresat e gjëra të popullsisë, prej nga duket se vinte. Në Dyrrah njohim, përveç Teutajës së Nikomahut, dhe Teutan, të bijën e Teutiut si dhe Teutajën, të bijën e Aleksenit; afër Zupcas gjejmë një tjetër Teuta<sup>35</sup> si dhe Teutamos, Teutmeitis, Teutiaplos, Theudas jashtë kufijve të vendit tonë. Të gjithë këta emra janë përfshirë vitet e fundit në listën e sistemit onomastik të zonës jug-lindore të Provincës Dalmate<sup>36</sup>.

Një veçanti për *Τευταια* është se në fund të emrit para gërmës alfa kemi një iota të zgjatur të dhënë me dy iota bashkë; ky është një element i çmueshëm fonetik që mund të na lejojë të njohim shqiptimin e drejtë e besnik të emrit në fjalë. (për emrin shiko dhe f. 184).

*Τιτος*, i njohur dhe më parë në Durrës nga një stele varri<sup>37</sup>, dëshmohehet në shumë mbishkrime të Dalmatisë dhe Dakisë<sup>38</sup>. Ai i përket dhe një prijësi të Taulantëve, birit të Glaukisë, që sundoi nga mbarimi i shek. III p.e.s.

Emrat e përmendur më lart përbëjnë një pjesë të onomastikës ilire. Kësaj liste i shtohen edhe: a) emrat e zbuluar kohët e fundit në qendra të tjera të Shqipërisë, dhe b) lista e emrave të botuar më parë dhe që janë komentuar apo konsideruar si ilirë. Do thënë nga ana tjetër se emrat që do të renditen më poshtë përbëjnë pjesën më të madhe, po jo krejt fondin e emrave vetjakë ilirë. Po rreshtojmë tani emrat sipas përhapjes gjeografike:

### Dyrrah

Nga mbishkrimet e gurëve të varreve të nekropolit:

Ανδρηα, Αντις (2 herë), Βρσυχος, Γενθιος, Δαζαιος, Δαζιος (2 herë), Επικαδος (4 herë), Επικαδος, Ζαμυνα, Κλειτια, Λαυδιας (2 herë), Λαιδων, Πλατωρ, Συρα, Συχος, Τατα, Τευταια, Τιτος; Αδαματας, Ανναια Annaea (2 herë), Annaius, Annula, Βενετος, Βερσαντος, Βρυγος, Εορταιος (2 herë), Επικαδος (2 herë), Φαλιος, Λαβια, (2 herë), Naevius, Πίτα, Sura, Τατα, Ταταια, Τειτος, Τευτα, Τευταια, Τευτιος, Τριτος, (2 herë), Voconia<sup>39</sup>, Billena, Sura, Voconia<sup>40</sup>; βατουα, Δαζαιος, Επτανης, Κικκω, Λαζιος, Λυδρα<sup>41</sup>, Βατινα, Σμιρας<sup>42</sup>; Artorius, Bennius, Epetinus, Epidamnus, Felicla, Pladomenus, Scodrina, Syrus, Todus<sup>43</sup>; Επικαδος, Γενθιος.<sup>44</sup>

35) A. Mayer, *vep. cit.* f. 81.

36) R. Katičić, *Suvremena istrazivanja o jeziku starosjedilaca ilirskih provincija — Die neuesten Forschungen über die einheimische Sprachschicht in den Illyrischen Provinzen — Simpozijum — Sarajevo 1964.*

37) V. Toçi, *Po aty*, Nr. 4, f. 74; Nr. 4, f. 52.

38) H. Krahe, *vep. cit.*, f. 116.

39) V. Toçi, *Mbishkrime e relievve nga nekropoli i Dyrrahit*, «Buletin i USHT Seria Shk. shoq.» Nr. 2, 1962 — Nr. 23, 33, 51 e 51, 51, 46, 28, 9, 24, 42 e 42, 9 e 25, 20, 35 e 36, 52, 6, 50, 31, 32, 4, 8, 34, 8, 26 e 27, 43.

40) H. Ceka — S. Anamali, *Mbishkrime latine të pabotueme të Shqipërisë*, «Buletin i USHT, Seria shk. shoq.» Nr. 1, 1961, Nr. 9, 9, 14.

41) S. Anamali, *Nekropoli helenistik i Epidamnit*, «Buletin për Shkencat Shoqërore», Tiranë Nr. 1, 1957, f. 55-56.

42) M. Buffa, *Trovamento di un cippo iscritto a Durazzo*, «Rivista d'Albania» Anno III, Fasc. IV, 1942.

43) P. C. Sestieri, *Mbishkrime latine të Shqipërisë — Iscrizioni latine d'Albania*, Tiranë 1942, nr. 56, 51, 53, 28, 49, 63, 70, 28, 62.

44) S. Anamali, *Të dhëna mbi elementin ilir në qytetet antike Epidamn dhe Apolloni*, «Buletin për Shkencat Shoqërore», Nr. 1, 1956, f. 24.

Nga legjendat e monetave të qytetit:

Αμυντας, (10 variante), Απο, Βοικην (4 var.), Γενθιος, Δαζιος, Εορταιος, (5 var.), Μονουιος, Μυτιλιος, Νεσσυλος, Σκυρδανας, Τριτος, (2 var.), Φαλακρων, (5 var.)<sup>45</sup>.

### Apollonia

Nga mbishkrimet e gurëve të varreve:

Αννυλα<sup>46</sup> Αγρων, Επικαδος, Μονουιος, Πλατορ, Τριτος<sup>47</sup>, Φαλακρα<sup>48</sup>.

Në vula tjegulle:

Επικαδος, Φαλακρος<sup>49</sup>.

Nga monetat e qytetit:

Αβρων (2 var.), Βατων, Βοικην, Γραβος, Επικαδος (2 var.), Πρευραδος. Φαλακρος, (2 var.)<sup>50</sup>

### Buthrot

Nga mbishkrimet e teatrit:

Αδματος, (4 herë), Αμυντας, (2 herë), Αννια, Απποιτας, Αρτεμω, Αρτεμιων, Γενθιος, Δερδας, Επικαδος?, Λεονατος, Μενοιτας, (12 herë). Νανα, Σαβυρτιος (2 herë), Φαλακρων (4 herë), Φαλακρος (6 herë)<sup>51</sup>.

Nga një monetë gjetur në qytet: Dastidius.

### Byllis

Në një fragmet mbishkrimi: Epicadus<sup>52</sup>.

### Lis

Në një mbishkrim që ruhet në manastirin e Shën Ndout:

Auca. Didia, Didius<sup>53</sup>.

Në legjendat e monetave të mbretit Gent (181-168 para erës sonë): Γενθιος.<sup>54</sup>

45) H. Ceka, *Probleme të numismatikës ilire*, Tiranë 1965 f. 20, 42-45, 140-152, 156-167; *Elementi ilir në qytetet Dyrrhachium dhe Apollonia*, «Buletin i Institutit të Shkencave», 3-4 (1951) 136. Për origjinën ilire të emrave Αδαματας e Αμυντας shih *Përputhje onomastike ilire-epirote* në «Studime historike», nr. 2, 1965, f. 85-90.

46) L. Heuzey — A. Daumet, *Mission Archéologique de Macédoine*, Paris, 1876, f. 402. Emri figuron në një pllakë mermeri që ruhet në Muzeun e Luvrit.

47) S. Anamali, *Po aty*, f. 24.

48) C. Praschniker — A. Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien 1919, f. 72.

49) H. Krahe, *Lexikon Altillyrischer Personennamen*, f. 88.

50) H. Ceka, *Probleme të numismatikës ilire*, Tiranë 1965 f. 136-138, 156-166.

51) K. Bozhorí — Dh. Budina, *Disa mbishkrime të pabotuara të teatrit të Butrintit*, «Studime historike» Nr. 2, Tiranë 1966, Nr. XVII, 17, 38, XXI, 18, XXVII, 1; VI 2, XVI 24; IX, 4; XXV, 9; VI, 7; VI, 7; XXVIII, 29; XIV, 8; XVIII, 25?, XVII, 57; 1, 9, II, 13, IV, 3, 5, V, 1, VIII, 15, XV, 6, XVII, 45, XXVI, 18, 24, XIX, 6, 10; XXI, 21; XXX, 10, 11; VIII, 5, 34, XVI, 21, XXIV, 4; IV, 11, IX, 36, XVI, 4, XVII, 25, XIX, 67, 68. Emrat nuk janë trajtuar nga ana e origjinës ilire, pasi nuk ka qenë ky qëllimi i autorëve.

52) P. C. Sestieri, *vep. cit.*, Nr. 20.

53) P. C. Sestieri, *vep. cit.*, Nr. 84.

54) S. Islami, *po aty*, f. 22.

## Skodra

Nga legjendat e monetave të mbretit Gent: Γενθιος<sup>55</sup>. Nga legjendat e monetave të qytetit të prera pas vitit 168 para erës sonë: Αδαματας<sup>56</sup>, Αδαματος, Αιυμιων, Πατρων, Τατο (?)<sup>57</sup>.

## Skampa

Në mbishkrimin e një plake dhe të tre altarëve varresh:  
Naevia, Itia, Plato<sup>58</sup>, Dona<sup>59</sup>.

*Ad Quintum* (Shënjon i Elbasanit)

Në mbishkrime altarësh — varresh: Parthinus<sup>60</sup>; A(p)u(d)ia, Plator<sup>61</sup>.

*Kajon i Dumresë* (Elbasan)

Në një shtyllëz varri ermë-portret: Μινασσα<sup>62</sup>.

*Petresh* (rrethi i Elbasanit)

Në një përkrenare ilire: Καυλας<sup>63</sup>.

*Kalaja e Irmajt* (Gramsh)

Në tri vula të njëllojta tjegullash: Τριτος<sup>64</sup>.

*Kozarë* (Rrethi i Beratit).

Në një stele varri: Επικαδος (3 herë)<sup>65</sup>, Τευτεα (2 herë)

*Kropisht* (Vlorë)

Në një gur varri: Pyramus<sup>66</sup>.

*Kolesjan* (Kukës)

Në një pllakë varri: Tata<sup>67</sup>.

*Selcë e Poshtme* (Mokër-Pogradec)

Në vulën e një gryke pitosi: Επικαδος<sup>68</sup>.

*Verri-Slatinë* (Mokër-Pogradec)

Në mbishkrimin e një guri varri: Λαζευνος, Κλειτος, Γενθιανος, Πλατωρ<sup>69</sup>.

## Strugë:

Nga një mbishkrim: Γενθιος.

## Pogradec

Në vulën e një gryke pitosi: Επικαδος<sup>70</sup>.

*Kalaja e Gradecit* (rreth i Kolonjë)

Në vulën e një gryke pitosi: Τριτος<sup>71</sup>.

55) S. Islami, *po aty*, f. 20.

56) H. Ceka, *vep. cit.* f. 156.

57) S. Islami, *po aty*, XIX, 1-7; XX, 1; XVI, 1; XXIV, 1.

58) H. Ceka — S. Anamali, *po aty*, Nr. 24, 21, 23.

59) P. C. Sestieri, *vep. cit.*, Nr. 91.

60) H. Ceka — S. Anamali, *po aty*, Nr. 1.

61) P. C. Sestieri, *vep. cit.* Nr. 89, 89.

62) Mbishkrimi i plotë është: Μινασσα Μιρυχαίρε. Ruhet i pabotuar në Muzeun e Elbasanit.

63) Sh. Arianiti, *Zbulim me rëndësi*, Rev. «Ylli», Nr. 3, 1967, f. 28. Përkrenarja u gjet në kodrën e Shënlliut në shtator të v. 1966.

64) F. Prendi — Dh. Budina, *Kalaja e Irmajt*, «Buletin i USHT». — Seria shkencat shoqërore» Nr. 4, 1963, f. 24.

65) Ruhet në pabotuara në Muzeun arkeologjik-etnografik të Tiranës.

66) H. Ceka — S. Anamali, *po aty*, Nr. 20.

67) H. Ceka — S. Anamali, *po aty*, Nr. 19.

68) Ruhet i pabotuar në Muzeun e Pogradecit.

69) Shih shënimin Nr. 15.

70) Shih shën. Nr. 21.

71) Ruhet i pabotuar në Muzeun e Ersekës.

*Kalaja e Kamnikut* (rrethi i Kolonjës)

Në vulën e një gryke pitosi:  $\text{Αμυντας}$  <sup>72</sup>.

Mbledhja e emrave që dhamë është një pasqyrim i shkurtër i trashëgimisë onomastike historike të vendit tonë. Ajo do të shtohet dhe do të plotësohet në të ardhmen me elementët e nevojshme për hartimin e një fjalori ku të rreshtohen dhe të ilustrohen të gjithë emrat vetjakë ilirë që vijnë nga burimet mbishkrimore të vendit tonë. Nga ana tjetër mbledhja e emrave na lejon të nxjerrim disa përgjithësime lidhur me vendburimet, përhapjen gjeografike, lashtësinë dhe vazhdimësinë e këtyre në truallin e atdheut tonë.

Një vështrim mbi fondin onomastik ilir tregon qartë se Dyrrahi është qendra që ka dhënë gjer tani numrin më të madh të emrave ilirë, prandaj e shohim të udhës të ndalemi së pari mbi këtë qytet dhe të japim disa mendime mbi themelimin dhe zhvillimin e tij. Sipas Appianit <sup>73</sup>, shkurtimeisht, një mbret barbar i këtij vendi i quajtur Epidamn, themeloi pranë detit një qytet të cilin e quajti me emrin e vet. I nipi i tij Dyrrahu, ndërtoi pranë këtij qyteti një liman të cilit i dha emrin Dyrrah. Skela kaloi me radhë në duar të pushtuesve: të brygëve, taulantëve dhe së fundi të liburnëve që u dëbuan nga korkyrasit. Pas kësaj këta të fundit përzinë me dyrrahsit kolonët e vet kështu që limani u konsiderua si helen. Nga thënjet e Appianit, megjithëse të përziera me elemente mitologjike, kuptojmë pra se kemi të bëjmë me një vendbanim të lashtë vendës, pranë të cilit u themelua kolonia e parë helene (viti 627 para erës sonë). Dëshmia e Appianit është interpretuar nga disa autorë thjesht si legjendë, por egzistojnë të dhëna që flasin për një vendbanim më të vjetër në të cilin u vendos kolonia greke. Vetë emri i qytetit  $\text{Ἐπίδαμνος}$ , që nuk u përdor pastaj nga romakët, është me origjinë ilire, sikurse e provon H. Krahe <sup>74</sup>, pavarësisht se ky autor emrin e dytë  $\text{Δυρράχιον}$  nuk e quan të tillë <sup>75</sup>. Nga ana tjetër, nga nekropoli kemi dokumenta që dëshmojnë për kulturën materiale ilire në qytet. Gjetjet e këtyre viteve për më tepër tregojnë shenjat e para se trualli ku është vendosur për afërsisht qyteti i sotëm ka qenë i banuar në kohëra më të lashta; këtë e dëshmojnë zbulimi i një çekani — sëpatë prej guri si dhe fragmente qeramike të kësaj kohe; interesant është dhe fakti se në një shpellë afër një rrjedhe uji në Hajdaraj të Kavajës është gjetur po ai tip çekani dhe prej të njëjtit material por më i madh. Kjo lë të supozojmë pra për qënjen e një kulture më të hershme në këtë pjesë të bregdetit tonë. Me zhvillimin e qytetit banorët vendës me hinterlandin e tyre ndikuan së tepërmi mbi administratën helene aq sa Dyrrahi si dhe fqinja e tij, Apollonia, u shkëputën shumë shpejt nga varësia politiko-ekonomike prej qyteteve Korint e Korkyrë. Popullsia u shtua në këtë kohë me shumë banorë ilirë dhe kështu u bë më i mundur evidentimi i emrave të tyre, të cilët vazhduan të ekzistojnë dhe gjatë pushtimit romak. Fakti se nga të gjitha mbishkrimet greke e latine të gurëve të varreve të nekropolit të marra së bashku, pothuaj një e treta e

72) Ruhet po ashtu i pabotuar në Muzeun e Ersekës.

73) Appianus, *Bella civilia*, II, 39.

74) H. Krahe, *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen*, Heidelberg, 1925, f. 23.

75) H. Krahe, *Vom Illyrischen zum Alteuropäischen*, «Indogermanische Forschungen», LXIX/3, Berlin 1964-65, f. 202. Sipas autorit emri Dyrrhachium është i përbërë nga fjalët greqishtë  $\delta\upsilon\sigma$  «keq» dhe  $\rho\alpha\chi\acute{\iota}\alpha$  «bregdet i thepisur, shkëmbor, përplasje dallgësh, poterë».

emrave vetjakë është me origjinë ilire, tregon diçka më tepër se raportet e zakonshme të një kolonie helene të vendosur në një territor të huaj. Edhe emrat e tjerë të vendit tonë, me rritjen numerike të tyre, e ngrenë tablonë e onomastikës ilire. Megjithatë, në gjendjen e tanishme të kërkimeve dhe me materialin burimor që disponojmë, është e parakoshme të japim një vlerësim tërësor mbi emrat, pasi fondi onomastik i Shqipërisë nuk është shteruar, por përkundrazi është në rritje e sipër. Duke u nisur nga kjo gjendje, pra, do të vemë shkurtazi theksin mbi ata emra ose grupe emrash që vetë ata apo me variantet e tyre paraqesin interes më të madh për ne.

Emri më i rëndomtë dhe më i përhapur në vendin tonë është *Επικαδος* të cilin me këtë grafi, sikur e kemi thënë dhe më lart, e gjejmë pothuaj vetëm në Shqipëri. Këtë e hasim në plot 18 raste të shpërndarë në disa qendra antike më të njohura si në Dyrrah (8 herë), Apolloni (4 herë), Buthrot, Byllis dhe Kozarë të Beratit (3 herë) e Pogradec. Në trajtën *Επι-cadus* emrin e ndeshim në Dalmati, Daki e Itali. Këtu përmendet ndër të tjerë një Epikad libert e gramatikan i Sulës dhe një tjetër Epikad skllav i liruar i Asin Polionit me origjinë partine. Më tutje akoma, në Greqi, gjejmë dhe një Epikad që ishte nga qyteti ilir Dimal. Këta shembuj si edhe ata që përmendëm në fillim kur trajtuam emrin në Dyrrah, lënë të kuptohet se *Επικαδος* është një emër karakteristik për Ilirinë e Jugut, ndoshta më tepër për viset bregdetare ku shtriheshin taulantët me fiset e afërta. Integrimi nga ana tjetër i parashtesës *επι* — në emër tregon se ka mundësi që ky të vijë dhe nga një fis afër Epidamnit dhe me këtë rast ka më tepër të ngjarë që *Επικαδος* të jetë me origjinë partine.

Një tjetër emër që ka filluar të bëhet i njohur në Shqipëri është dhe emri *Πλατωρ* — Plator, që greqisht shkruhej dhe *Πλευρατος* (në një monetë të Apollonisë kemi gjindoren *Πλευραδου*). Ky emër dëshmohej tek ne në 7 raste: 2 në Dyrrah, 2 në Apolloni, 1 në Ad Quintum, 1 në Tren, 1 në Verri-Slatinë të Pogradecit, ndërsa jashtë kufijve të vendit tonë sikurse dhe *Επικαδος* figuron më tepër në vendet që përmendëm d.m.th. në Dalmati, Daki e Mesapi. Nga pikëpamja e origjinës shoqërore bartësit e këtij emri janë banorë të zakonshëm, por nuk mungojnë dhe raste kur disa prej tyre u përkisnin shtresave të larta. Kështu p.sh. një ilir në Apolloni kishte arritur shkallën e lartë të prytanit, një tjetër ishte udhëheqës ushtarak dhe më tepër akoma vetë vëllai i mbretit Gent quhej Plator. Pavarësisht nga ky konstatim, zbulimet e reja epigrafike në nekropolet e qyteteve tona antike po e nxjerrin në pah gjithnjë më tepër këtë emër dhe kjo ka rëndësi për ne.

*Δαζιος* — Dasiu është emri më i njohur ilir. Atë e kanë krahasuar me shqipen «dash». Një tjetër shpjegim e sjellë nga indoevr. *dek-* «marr, përshëndes, paraqes nderime»<sup>76</sup>. Në Iliri dhe jashtë saj njihen mbi 150 shembuj të përndarë sidomos në Dalmaci, Panoni, Daki e Mesapi. Tani për tani te ne ky emër del vetëm në Dyrrah (5 herë) e në Butrint. Pritet që ai të bëhet i njohur dhe në të tjera vende të Shqipërisë.

Emrat *Βατων* në Apolloni dhe *Βατινα* e *Βατουνα* në Dyrrah janë variante të emrit Bato, të cilin e kanë mbajtur persona me shkallë shoqërore dhe profesione të ndryshme; princër, ushtarakë, zejtarë, historianë, poetë etj. Por në radhë të parë emri na kujton dy figurat popullore historike, dy Batot që rrokën armët kundër Romës: i pari një panonas nga fisi ilir i Breukëve që udhëhoqi kryengritjen e madhe të viteve 6-8

76) Sipas I. I. Russut. *po aty*, f. 95.

të erës sonë, e cila kërcënoi dhe vetë sigurinë e shtetit romak, i dyti një dalmatas që priu po në këtë kohë kryengritjen kundër pushtuesve. Mund të thuhet se Bato është emri me shtrirje gjeografike më të madhe në Iliri dhe përtej kufijve të saj.

Kohët e fundit në Durrës ka dalë në dritë dhe emri *Συρα* — Sura që e kemi gjetur në varrezën e lashtë si në mbishkrimet greke ashtu dhe në ato latine; në këto të fundit Sura na del në dy raste si sklave. Në Dyrrah kemi dhe një Syrus. Ky ishte ai Epidamnus Syrus që, sipas një mbishkrimi të shek. II sot në Luvër, kishte arritur pozitë të lartë në qytet: ai i përkiste Urdhërit të kalorisë, kishte detyrën e flaminit, të augurit, të duumvirit pesëvjeçar, mbante gjithashtu titullin e Praefectus fabrum të kolegjit të «Fabri tignari» dhe ishte mbrojtës i kolonisë së Dyrrahit<sup>77</sup>. Surus-a, sikurse ka treguar V. Shulce, ka qenë dhe emër kelt dhe bile trak<sup>78</sup>, por ai dokumentohet gjerësisht në Iliri dhe konsiderohet si një nga të pesë emrat më të njohur ilirë, krahas Dazit, Epikadit, Batos e Platorit.

Një emër që me larminë e varianteve në Dyrrah formon si të thuash një grupth më vete është *Τευτα-s*. Këtij emri i vijnë pranë *Τευτιος*, *Τευταια*. *Τευταια* në Dyrrah dhe *Τευτεια* (2 herë) në Kozarë të Beratit. Prania e këtij emri në vendin tonë është me rëndësi, pasi ai është i lashtë dhe kuptimi i tij etimologjik formon një element lidhjeje e krahasimi për disa popuj e gjuhë kryesore të Evropës.

Lidhur me emrin e Teutës, për afërsi figurash të njohura historike ilire po përmendim dhe emrin e *Γενδιος* që ka filluar të dalë rëndom dhe tek ne, pasi, sikur e kemi thënë, ai figuron në mjaft monedha të Lisit, Skodrës, në një drahme të Dyrrahit dhe në mbishkrime të këtij qyteti, të Buthrotit, Strugës e Selcës së Poshtme. Pranë kësaj zone të fundit, në Verri-Slatinë të Mokrës, duket një *Γενδιανος* emër vetjak që në trajtën Gentianus mund ta krahasojmë me huazimin ilir «gentiana», bimë e cila, sipas Plinit (N.H. XXV, 71), ka marrë këtë emër nga mbreti ilir Gentius<sup>79</sup>.

Në radhën e emrave të mësipërm po përmendim së fundi dhe dy grupthe emrash që kanë lidhje me Anna e Tata, që të dy emra të njohur belbëzimi. Nga emri Anna që duket se ka pasur dhe kuptimin «dada»<sup>80</sup> kemi trajtat e zhvilluara: në Dyrrah *Ανναία*, Annaius, Annea (2 herë), Annula, në Apolloni *Ανουλα* dhe në Buthrot *Αννια*. Nga emri Tata kemi *Τατα* dhe *Ταταια* në Dyrrah, një Tata tjetër në Kolesjan të Kukësit dhe një *Τατο* (?) në Skodër.

Këta qenë disa nga emrat vetjakë që vumë në pah: do të mund të përmendim emra të tjerë jo me më pak vlerë se ata që rrjedhin nga fiset (*Αβρων*, *Αριμων*, Parthinus), *Βρυγος*, *Εορταιος*, *Βενετος* nga qytetet (Epidamnus, Skodrina, Epetinus), emra besilejsh (*Μονουσιος*, *Μυτιλ[ος]*), prytanësh (*Αβρων*, *Επικαδος*, *Βοικην*, *Εορταιος*, *Πρευραδος*, (Ap.): *Αμυντας*, *Απο*, *Βοικην* *Νεσσυλος*, *Σκυρθνας*, *Φαλακριων* (Dyrr.) etj.: por nuk është për tani qëllimi ynë. Ajo që ka rëndësi për ne është të vëmë tashti në dukje kontributin e emrave vetjakë ilirë të Shqipërisë në fondin e përgjithshëm onomastik ilir. Ky kontribut përfaqësohet si nga emrat e rëndomtë ilirë të vendit tonë ashtu dhe prej atyre emrave vetjakë që janë të rrallë ose kanë dalë për herë të parë të ne. Përsa

77) P. C. Sestieri, *vep. cit.* Nr. 28.

78) W. Schultze, *Zur Geschichte der lateinischer Eigennamen*, Berlin 1904, 43 nota 3.

79) H. Krahe, *Sprache der Illyrier I*, f. 117.

80) H. Krahe, *vep. cit.*, f. 79.

i përket këtyre të fundit, po të bëjmë një krahasim me repertorin e antroponimeve të H. Krahes vërejmë se 8 emra përmenden aty vetëm në një, dy ose tre raste, 8 të tjerë janë në fjalor por me grafi të kundërt greke apo latine dhe 57 emra nuk figurojnë fare në të, si Αβρων, Αδαματας, Αριμων, Αριυντας, Απποιτας, (Α)ρ(υ)δ(ι)α, Artorius, Βερααντος, Βραυκος, Βρυγος, Felicia, Λαιδων, Λυδρα, Μενοιτας, Νανα, Σαβυρτιος, Τευταια, Τευtea, Τευτιος Ζαμυνα etj. Këta emra përbëjnë pothuaj më tepër se një të tretën e fondit tonë dhe, bashkë me emrat e rëndomtë janë një pasurim i krejt trashëgimisë onomastike ilire. Njëkohësisht emrat përcaktojnë hë për hë profilin dhe vendin e antroponimisë sonë në sferën e gjuhës dhe të popullsisë ilire si dhe popujve përrreth e veçanërisht atyre të Ballkanit. Kështu, në këtë vështrim një varg emrash si Daz, Bato, Epikad, Plator, Gent, Sura, Teuta, Apudia, Benet, Andena, Boiken, Itia, Tata etj. që i gjejmë në vendin tonë dhe në Dalmati, Panoni, Daki, Norik, Veneti, Mesapi dhe vise tjera, pavarësisht nga vendi i përhapjes së tyre apo qendra e rrezatimit, dëshmojnë për lidhje gjuhe, kulture e kompaktësi etnike të trevës ilire: të tjerë emra si Daz, Bato, Suro, Epikad, Gent, Teuta, Teutio, Teutea, Agron, Epetin, Pladomen, Patron, Tata etj. tregojnë për afërsi me krahinat e Dalmacisë juglindore, disa të tjerë si Plator, Daz, Lajd, Kailla flasin qartë për marrëdhëniet me vendin e Mesapëve kurse mjaft emra si Adamat, Amynta, Anna, Annia, Annyla, Apoita, Menoita, Falaker, Klito e Leonat dëshmojnë për lidhjen iliro-epirote dhe iliro-maqedone. Këto të dhëna përputhen nga ana tjetër me ngjarjet historike. Në fakt emrat e zbuluar i përkasin asaj kohe që përkon me dendësimin e marrëdhënjeve ekonomiko-kulturore të vendit tonë me viset italice të krahut juglindor të Gadishullit, me pushtimin e shkurtër maqedon në Shqipëri dhe me luftën në mes ilirëve e romakëve për hegjemoninë mbi detin Adriatik. Duke u nisur nga këto konsiderata do të ishte e dëshirueshme që në Shqipëri të zbuloheshin dokumenta mbishkrimorë ku të figuronin emra ilirë të një periudhe akoma më të hershme, kohë për të cilën kanë dhënë rezultate të kënaqshme zbulimet arkeologjike në lëmin e kulturës materiale ilire.

Një anë tjetër e problemit onomastik është dhe çështja e përhapjes gjeografike të emrave ilirë në vendin tonë. Lidhur me këtë, tani për tani, në pritje të një antroponimie më të pasur është e parakohshme të caktojmë zonat që kanë qenë bërthama të çdo emri. Sikur e pamë në pasqyrën që dhamë, emrat te në vijnë nga qytetet bregdetare Dyrrah, Apollonia, Skodra, Lis e Buthrot; por ata i ndeshim gjithashtu dhe në viset e brendshme si në fshatin Petresh, në Kajon të Dumresë, në kalanë e Irmajt, në qytetin e Elbasanit, në Kozarë të Beratit, në Kropisht të Vlorës dhe akoma më thellë në Kolesjan të Kukësit, në Pogradec, në Kalanë e Gradecit dhe të Kamnikut të rrethit të Kolonjës. Prania e të huajve nga ana tjetër dhe hyrja e dalja e tyre në portet nuk ua ul vlerën dokumentare emrave ilirë që hasim këtu, pasi thelbin e popullsisë e përbënin vendësit dhe ishin zonat fushore e kodrinore dhe pas tyre ato maloret që ushqenin me banorë këto qendra. Dhe nëse për bregdetin tonë pretendohet mungesa e një leksiku detar vendas, kjo nuk i duhet veshur mungesës ose largimit të vendësve, por vetëm e vetëm rrethanave historiko-ekonomike, të cilat bënë që edhe te popujt e tjerë mesdhetarë të predominojë terminologjia e huaj detare<sup>81</sup>. Populli i këtyre vendeve nuk i shkëputi kurrë dhe krejtësisht lidhjet me detin. Akoma sot ruhen zakone të

81) L. Doddiba, *Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara* «Studime filologjike», 1, 1967, f. 35-39.

lashta që flasin për to. Kështu për shembull në ditë të caktuar të verës apo vjeshtës gratë dhe burrat e krahinës së largët të Martaneshit, Shtpatit, Dumresë dhe viseve të thella zbresin çdo vit ne det për t'u larë.

Duke i parë dhe një herë emrat nga ana e vlerës dokumentare, del se gjer tani ata i kemi kryesisht nga mbishkrime greke dhe këta përgjithësisht janë nga më të lashtët. Mjaft emra megjithatë ruajnë në trajtën latine vazhdimësinë e tyre dhe në kohën e mëvonshme të pushtimit romak; për më tepër një varg syresh i kemi vetëm nga kjo kohë. Pas shembjes së perandorisë romake evidentimi i emrave ilirë si dhe i shumë të dhënave të jetës së popullit nuk u bë i mundur për shkak të pushtimeve të një-pasnjëshme të vendit tonë nga të huajt. Megjithatë mendimi i shfaqur te ndonjë autor se gjuha shqipe nuk mund të quhet si vazhduese e drejtpërdrejtë e gjuhës ilire, sepse, ndër të tjera, «Shqiptarët nuk kanë trashëguar nga lashtësia asnjë element kultural (asnjë emër ilir vetiak apo vendi)»<sup>82</sup>, duket i pavërtetueshëm. Në malësitë tona apo në viset e brendshme ruhen emra individualë me origjinë ilire si Sutë, Vatë, Meitime, Buli, Siku etj. që nuk janë përputhje onomastike të rastit<sup>83</sup>. Për më tepër mund të mendojmë se dhe disa emra si p.sh. Anna, Bato, Kike, Laid, Zaje, etj., që i gjejmë të njëlojtë ose me pak ndryshime në repertorin e emrave ilirë, nuk duhet t'i marrim thjesht si emra apo shkurttime emrash (Ana, Bahtjar, Haki, Adelaid, Zaje) të huazuara nën ndikimin e ideologjisë fetare të ardhur me pushtimet e huaja. Është më e besueshme të supozohet se shqiptarët, si gjithë popujt e tjerë, kanë preferuar të mbajnë në radhë të parë ata emra të huaj që shembëllojnë më tepër me emrat vendës, sikurse ka ndodhur në raste të tjera në kohëra të lashta në viset ilire<sup>84</sup>. Kërkimet e studimet sistematike në këtë drejtim në zonat më të pastra gjuhësore mund të çojnë në përfundime të ndjeshme<sup>85</sup>.

Në hyrje të punimit sonë dhamë një përmbledhje të shkurtër mbi zhvillimin e konceptit ilirishte. Këtë e bëjmë më tepër për të ndjekur udhën e onomastikës ilire, e cila ka pasur pjesën e saj të rëndësishme në interpretimet e reja; pse, sikurse e prekëm edhe më lart, kanë qenë në radhë të parë emrat e vendeve dhe të personave ata që kanë ndikuar në zgjerimin e konceptit ilirishte, pasi nga gjuha e lashtë përpos këtyre emrave të

82) I. I. Russu, *vep cit.* f. 102. Për origjinën e gjuhës shqipe dhe popullit shqiptar janë shprehur shumë dijetarë në mes të të cilëve: a) Për origjinë ilire. I. Thunmann, G. Meyer, P. Kretschmer, M. Sufflay, A. Meyer, E. Çabej, W. Cimochoowski; b) thrake: H. Hirt, G. Weigand, D. Detchev, I. I. Russu; c) thrako-ilire: N. Jokl, St. Mladenov; d) dako-myze me komponentë të njëlojtë ilirë V. Georgiev. Të gjithë këta autorë kanë mbajtur qëndrimin e tyre ndaj këtij problemi të rëndësishëm, duke u nisur nga vlerësimet historiko-gjuhësore, mbështetur më shumë o më pak mbi toponiminë, etnoniminë dhe antroponiminë. Mbi autoktoninë dhe vendin e lashtë të shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit, kanë vlerë të veçantë për në veprat e E. Çabejt: *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, «Buletin i USHT, Seria shk. shoq.» 1959, II: *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës e të emrave të vendeve*, në po atë Buletin 1962, I.

83) Përpyekje në fushën e përputhjeve shqiptaro-ilire janë ndërmarrë nga Gelasius (Nikollë Gazulli) te vepra e tij *Fjalori toponomastik* në «Hylli i Dritës» 1939-1943. Për konkordancat iliro-epirote kemi punimin e parë me kumtesën e H. Cekës: *Përputhje onomastike ilire epirote* në «Studime historike», Nr. 2, 1965 f. 87.

84) Krahas emrat Epicadus-Epidius të R. Katičić, *Die Illyrischen Personennamen in ihren südöstlichen Verbreitungsgebiet*, «Živa Antika», 12, Skoplje f. 103; khs. dhe Βάλακρος — Φάλακρος, Βάλιος — Φάλιος.

85) Një studim kritik me vlerë mbi historinë e kërkimeve onomastike në fushën e gjuhës shqipe ka bërë dy vite të shkuara A. Kostallari (A. Kostallari, *Contribution à l'histoire des recherches onomastiques dans le domaine de l'albanais*, «Studia Albanica» Nr. 1, 1965).

përveçëm, janë ruajtur gjer tani vetëm pak glosa. Lidhur me këtë konstatim mund të themi, nga ana tjetër, se dhe faktori që ka shtyrë H. Krahen të caktojë si vendburim të emrit ilir dhe të popullit ilir zonën e lumit Drin, ka qenë me të drejtë, përveç të dhënave të autorëve antikë, dhe onomastika e pasur e kësaj zone si dhe e viseve pranë saj, sidomos ajo e Dalmacisë. Për këtë arsye ndofta ilirologu i njohur do të jepte një lokalizim dhe më të saktë brenda kufijve të Shqipërisë, sikur ai të kishte ndeshur në atë kohë te ne një antroponimi të pasur ilire, si te viset nga krahu tjetër i lumit Drin. Ndërkaq duhet vënë në dukje se në Shqipëri prej fillimit të shekullit e deri afër mesit të tij kanë dalë në dritë nga zbulimet e rastit mbishkrime që mbajnë emra individësh ilirë. Nga dëshmi gojore dimë shumë kësi rastesh, por për fat të keq këto dokumenta kanë humbur ose kanë shkuar dëm. Ndryshe është gjendja tani; me zbulimin dhe botimin e grupit të parë të emrave ilirë të Durrësit është krijuar një fushë e re onomastike<sup>86</sup>, e cila po vjen duke u pasuruar gjithnjë e më tepër. Kështu brenda dy dekadave në një territor të kufizuar si vendi ynë, është gjendur një numër jo i vogël emrash, aq sa na bën të shpresojmë se në një të ardhme jo të largët, me vrullin e tanishëm të kërkimeve<sup>87</sup>, do të kemi një fond shumë të çmuar antroponimesh që do të bëhet objekt studimi për thellimin në gjuhën dhe në historinë e ilirëve. Atëhere mund të themi, duke u bashkuar dhe me cilësimin e dy gjeografëve romakë që përmendëm në fillim për Ilirinë e Jugut, se pikërisht në vendin tonë do kërkuar dhe pikënisja ose qendra e përhapjes së shumë prej këtyre emrave.

86) C. de Simone, *Osservazioni sull'onomastica della necropoli di Durazzo*, f. 125.

87) Në mbishkrimet e gurëve të varreve të zbuluara këto ditë në nekropolin e Dyrrahit kemi dalluar një numër të konsiderueshëm emrash vetiakë ilirë. Këta emra po i shtrohen një studimi të veçantë.

#### EMRAT VETIAKË ILIRË TË SHQIPËRISË

Αβρων	m.	Apollonia (2 variante monetash) *
Αδαματας	m.	Dyrrah, Skodra *
Αδαματος	m.	Skodra *
Αδματος	m.	Buthrot (4 herë)
Αγρων	m.	Apollonia
Αμυρων	m.	Skodra *
Αμυντας	m.	Dyrrah (10 var.) *, Buthrot (2 herë), Kalaja e Kamnikut (Kolonjë)
Ανθηνα	f.	Dyrrah
Ανναια	f.	Dyrrah
Αννια	f.	Buthrot
Annaius	m.	Dyrrah
Annea	m.	Dyrrah (2 herë)
Αντις	f.	Dyrrah (2 herë)
Annula	f.	Dyrrah
Αννυλα	f.	Apollonia
Απο	m.	Dyrrah *
Απποντας	m.	Buthrot
A(p)u(d)ia	f.	Ad Quintum (Shenjon-Elbasan)
Αρτεμω	f.	Buthrot
Αρτεμων	m.	Buthrot
Artorius	m.	Dyrrah
Auca	f.	Lis
Βατινα	f.	Dyrrah
Βατων	m.	Apollonia *

Βατουνα	f.	Dyrrah
Βενετος	m.	Dyrrah
Bennius	m.	Dyrrah
Βερσαντος	m.	Dyrrah
Billena	f.	Dyrrah
Βοικην	m.	Dyrrah (4 var.) *, Apollonia *
Βρσυκος	m.	Dyrrah
Βρυγος	m.	Dyrrah
Dastidius	m.	Buthrot *
Δαζαιος	m.	Dyrrah (2 herë)
Δαζιος	m.	Dyrrah (2 herë) + (1 var.)*
Δερδας	m.	Buthrot
Didia	f.	Lis
Didius	m.	Lis
Dona	f.	Skampa
Εφικαδος	m.	Pogradec
Εορταιος	m.	Dyrrah (2 herë) + (5 var.)*
Epetinus	m.	Dyrrah
Epidamnus	m.	Dyrrah
Επικαδος	m.	Apollonia (2 herë) + (2 var.)*, Buthrot, Dyrrah (7 herë), Kozarë (Berat) (3 herë)
Epicadus	m.	Byllis
Επικαδος	m.	Dyrrah
Επτανης	m.	Dyrrah
Φαλακρα	f.	Apollonia
Φαλακρων	m.	Dyrrah (5 var.)*, Buthrot (4 herë)
Φαλακρος	m.	Apollonia + (2 var.)*, Buthrot (6 herë)
Φαλιος	m.	Dyrrah
Felicla	f.	Dyrrah
Γενθιανος	m.	Verri-Slatinë (Mokër-Pogradec)
Γενθιος	m.	Buthrot, Dyrrah (2 herë) + (1 var.)*, Lis *, Skodra *, Selcë e Poshtme (Mokërr-Pogradec), Strugë.
Γραβος	m.	Apollonia *
Itia	f.	Skampa
Καυλαος	m.	Petresh (Elbasan)
Κικω	f.	Dyrrah
Κλειτια	f.	Dyrrah
Κλειτος	m.	Verri-Slatinë (Mokër-Pogradec)
Λαβια	f.	Dyrrah (2 herë)
Λαιδιας	m.	Dyrrah (2 herë)
Λαιδων	m.	Dyrrah
Λαζεινος	m.	Verri-Slatinë (Mokër-Pogradec)
Λαζιος	m.	Dyrrah
Λεονατος	m.	Buthrot
Λυδρα	f.	Dyrrah
Μενοιτας	m.	Buthrot (12 herë)
Μινασσα	f.	Kajon i Dumresë (Elbasan)
Μονουνιος	m.	Apollonia, Dyrrah *
Μυτιλ[ος]	m.	Dyrrah *
Νανα	f.	Buthrot
Naevia	f.	Skampa
Naevius	m.	Dyrrah
Νεσσυλος	m.	Dyrrah *
Parthinus	m.	Ad Quintum (Shënjon-Elbasan)
Πατρων	m.	Skodra *
Πιτα	f.	Dyrrah
Pladomenus	m.	Dyrrah
Plato	f.	Skampa
Πλατωρ	m.	Apollonia, Dyrrah (2 herë), Tren, Verri-Slatinë (Mokër-Pogradec)
Plator	m.	Ad Quintum (Shënjon-Elbasan)
Πρενραδος	m.	Apollonia *
Pyramus	m.	Kropisht (Vlorë)
Σαβυρτιος	m.	Buthrot (2 herë)
Scodrina	f.	Dyrrah

Σκυρδανας	m.	Dyrrah *
Συρας	m.	Dyrrah
Συχος	m.	Dyrrah
Συρα	f.	Dyrrah
Sura	f.	Dyrrah (2 herë)
Syrus	m.	Dyrrah
Tadus	m.	Dyrrah
Τατα	f.	Dyrrah (2 herë)
Tata	f.	Kolesjan (Kukës)
Τατανα	f.	Dyrrah
Τατο (?)	m.	Skodra *
Τειτος	m.	Dyrrah
Τιτος	m.	Dyrrah
Τευτα	f.	Dyrrah
Τευταια	f.	Dyrrah
Τευταια	f.	Dyrrah
Τευτεα	f.	Kozarë (Berat) (2 herë)
Τευτιος	m.	Dyrrah
Τριτος	m.	Apollonia, Dyrrah (2 herë) + (2 var.)* Kalaja e Gradecit (Kolonjë), Kalaja e Irmajt (Gramsh) (3 herë)
Voconia	f.	Dyrrah
Ζαμυνα	f.	Dyrrah

## R é s u m é

## DONNEES SUR L'ONOMASTIQUE ILLYRIENNE A DYRRHACHIUM ET DANS D'AUTRES CENTRES DE L'ALBANIE

La théorie traditionnelle d'une langue unitaire illyrienne parlée approximativement sur le territoire compris entre les dialectes celtes de la vallée du Pô et le macédonien, dont l'extension à l'est va jusqu'au Danube, a été remise en question ces derniers temps. On a déjà des opinions nouvelles sur quelques tribus illyriennes, notamment sur les Vénètes et les tribus au N.-O. de la Péninsule Balkanique, qui considèrent leur parler comme une unité linguistique close et mettent l'accent sur d'autres particularités distinctives. Ces conclusions ont donné le jour, d'autre part, aussi au besoin de distinguer plusieurs zones linguistiques et de déterminer les liens de celles-ci à l'intérieur de la région illyrienne. C'est pour ces raisons, donc, qu'un intérêt particulier est porté au territoire de l'Illyrie méridionale, appelé par Pline et Pomponius Mela comme «l'Illyrie proprement dite», puisque dans ce territoire, où se trouve précisément aussi l'Albanie, on suppose qu'ait été parlée cette langue qui doit être considérée, avant tous les autres dialectes, comme langue illyrienne.

Cette considération a sa valeur du fait que c'est sous ce prisme que doivent être envisagés les noms personnels illyriens mis au jour par l'auteur et par d'autres durant ces années en Albanie, notamment dans la nécropole de Dyrrhachium. L'auteur fournit une nouvelle liste de ces noms parus à Dyrrhachium, à laquelle il ajoute aussi les autres noms illyriens venus au jour sur d'autres points de l'Albanie ou au voisinage de celle-ci. Jusqu'à présent, Dyrrhachium est le centre qui a donné le plus grand nombre de noms illyriens. Néanmoins, à l'état actuel des recherches et du matériel documentaire qu'on dispose, il serait encore prématuré de

Shënim: Të gjithë emrat vijnë nga burimet mbishkrimore. Yllëza (\*) pranë vendit të gjetjes tregon se emri është lexuar në monetë.

donner une estimation totale sur les noms, du fait que le fonds onomastique de l'Albanie n'a pas tari, que tout au contraire il est en hausse continue. D'ailleurs, l'auteur se repromet de retourner bientôt sur l'argument, ayant mis au jour pendant ce temps encore d'autres noms personnels sur des pierres sépulcrales.

Toute considération faite, l'auteur, — après avoir donné la liste de ses dernières trouvailles et dressé les index nécessaires, que le spécialiste peut consulter dans le texte ci-contre en albanais, — met l'accent sur des noms ou des groupes de noms qui offrent un plus grand intérêt sous le prisme que nous venons d'indiquer.

Le nom le plus commun et le plus diffusé dans tout notre pays est *Επικαδος*, qui se retrouve presque exclusivement en Albanie avec cette graphie. On le retrouve dans plus de 18 cas distribués sur plusieurs centres antiques connus comme Dyrrhachium (8 fois), Apollonie (4 fois), Bouthroton, Byllis et Kozare de Berat (3 fois), Pogradec. Sous la forme d'Epicadus on le retrouve en Dalmatie, Dacie et Italie. Ici il est porté mention d'un Epicade, affranchi et grammairien de Sylla, et un autre Epicade, un esclave affranchi de Asinius Pollion, d'origine parthène. En Grèce, on trouve un Epicade originaire de la ville illyrienne de Dimale. Ces exemples et les autres ci-dessus montrent que *Επικαδος* est un nom caractéristique à l'Illyrie méridionale, peut-être plutôt aux régions côtières où s'étendaient les Talantins et les tribus voisines. D'autre part, l'intégration du préfixe *επι* — est à indiquer également qu'il peut provenir d'une gens au voisinage d'Epidamne, et ainsi il est bien probable que *Επικαδος* soit d'origine parthène.

Un autre nom qui a commencé d'être connu en Albanie est aussi *Πλατορ* — Plator, qu'on écrivait en grec également *Πλευρατος* (sur une monnaie d'Apollonie on a le génitif *Πλευραδου*). Ce nom est attesté chez nous dans 7 cas: 2 à Dyrrhachium, 2 à Apollonie, 1 Ad Quintum, 1 à Tren, 1 à Verri-Slatine de Pogradec. En dehors de nos frontières, tout comme Epikados, il figure plutôt dans les pays de la Dalmatie, Dacie et Messapie. Au point de vue de l'origine sociale, les porteurs de ce nom sont des gens du commun, mais ne manquent non plus les cas dans les hautes couches. Ainsi, p. ex., un Illyrien en Apollonie avait atteint le haut grade de prythane, un autre était un guide militaire et encore le frère du roi Genthios était appelé Plator. Indépendamment de cette constatation, les autres découvertes épigraphiques dans les nécropoles de nos villes antiques font mettre au jour encore ce nom, et cela est d'importance.

*Δάζιος* -Dasius est le nom illyrien le plus connu. On a voulu le comparer à l'albanais *dash* = «bélier». Une autre explication le rattache à l'i.-e. *dek-* «prendre, saluer, présenter ses salutations». En Illyrie et à l'étranger sont connus plus de 150 exemples distribués notamment en Dalmatie, Pannonie, Dacie et Messapie. Pour le moment, chez nous le nom est présent seulement à Dyrrhachium (5 fois) et à Bouthroton. On s'attend qu'il devienne connu également dans d'autres régions de l'Albanie.

*Βάτων* en Apollonie et *Βατινα*, *Βατουνα* à Dyrrhachium représentent des variantes du nom Bato, porté par des individus de degré social et de profession diverses: princes, militaires, artisans, historiens, poètes, etc. Mais ce nom nous rappelle, en tout premier lieu, les deux figures historiques: les deux Bato qui ont pris les armes contre Rome: le premier, un Pannonien, de la tribu illyrienne des Breuces, qui dirigea la grande insurrection des années 6-8 de notre ère, qui menaça la sécurité même de l'Etat romain; le deuxième, un Dalmate, qui dirigea à la même époque l'insur-

rection contre les envahisseurs. On peut déclarer que Bato est un nom de grande extension en Illyrie et outre ses frontières.

Ces derniers temps à Durrës est venu au jour aussi le nom de *Συρα* — Sura, que nous avons trouvé dans la nécropole antique, tant sur les inscriptions grecques que celles latines. Sur ces dernières, Sura résulte dans deux cas comme esclave. A Durrës on a également un Syrus. C'était cet Epidamnus Syrus qui, d'après une inscription du II<sup>e</sup> siècle, actuellement au Louvre, avait atteint un grade dans la ville: il appartenait à l'Ordre de la Cavalerie, avait la tâche de flamme d'augure, de *duumvir quinquennal*, il portait également le titre de *Praefectus fabrum* du collège des «Fabri tignari» et était le protecteur de la colonie de Dyrrhachium. Surus, comme l'a montré W. Schultze, a été également un nom celte et même thrace, mais il est documenté amplement dans l'Illyrie et est considéré comme un des cinq noms connus illyriens à côté de Daze, Epicade, Batos et Plator.

Un nom qui, par la multitude de variantes à Dyrrhachium forme comme à dire un petit groupe à part est *Τευτά*. A ce nom se rapprochent *Τευτιος*, *Τευταια*, *Τευταια* à Dyrrhachium et *Τευτέα*, (2 fois) à Kozare de Berat. La présence de ce nom dans notre pays est importante, puisqu'il est antique et son étymologie forme un élément de connexion et de comparaison pour plusieurs peuples et langue principales de l'Europe.

A côté du nom *Teuta*, pour affinité de figures historiques illyriennes connues, nous mentionnerons aussi *Γενθιος*, qui a commencé à sortir habituellement chez nous, puisque, comme nous venons de le faire remarquer, il figure sur plusieurs monnaies de Lissus, Skodra, sur une drachme de Dyrrhachium et sur des inscriptions de cette ville, de Bouthroton, Struge, Basse-Selce. Au voisinage de cette dernière zone, à Verri-Slatine de la Mokër, on a un *Γενθιανος*, nom personnel qu'on peut comparer, sous la forme de *Gentianus*, avec l'emprunt illyrien «Gentiana», une plante qui, d'après Pline a pris ce nom du roi illyrien *Genthius*.

Dans les noms ci-dessus, l'auteur mentionne enfin deux petits groupes qui se rattachent à Anna et Tata, tous les deux des noms connus hypocoristiques. Du nom Anna, qui semble avoir eu aussi le sens de «nourrice» (H. Krahe) on a les formes développées: Durrës *Αννια*, Annaius, Annea (2 fois), Annula, à Apollonie *Αννυλα* et à Bouthroton *Αννια*. Du nom Tata on a *Τατα* et *Ταταια* à Durrës, un autre Tata à Kolesjan de Kukës et un Tato (?) à Shkodër.

On pourrait mentionner d'autres noms de nom moindre valeur comme ceux qui proviennent des tribus (*Αβρων*, *Αμυμων*, Parthinus, *Βρυγος*, *Εορταιος*, *Βενετος*), des villes (Epidamnus, Skodrina, Epetinus), des noms de basilei (*Μονουνιος*, *Μυτιλ[ος]*), de prytanes (*Αβρων*, *Επικαδος*, *Βουκην*, *Εορταιος*, *Πρευραδος* [Apollonie]: *Αμυντας*, *Απο*, *Βουκην*, *Νεσσυλος*, *Σκυρδανας*, *Φαλακρων* [Dyrrhachium], etc.

Ce qui a de l'importance pour nous est de mettre en vue la contribution des noms personnels illyriens de l'Albanie dans le fonds général onomastique illyrien. Cette contribution est représentée tant par les noms communs illyriens de notre pays que par ces noms personnels qui sont rares ou bien qui sont venus au jour pour la première fois chez nous. Pour ce qui est de ces derniers, si l'on fait une confrontation avec le répertoire des anthroponymes de H. Krahe, l'on constate que 8 noms n'y sont mentionnées que dans un, deux ou trois cas, 8 autres figurent dans le lexique mais à graphie contraire grecque ou latine et 57 noms n'y figurent point, comme *Αβρων*, *Αδαματας*, *Αμυμων*, *Αμυντας*, *Απποιτάς*, *Α(ρ)υ(δ)ια*, *Artorius*, *Βερσαντος*, *Βρσυκος*, *Βρυγος*, *Felicia*, *Λαιδων*, *Λυδρα*, *Μενοιτας*, *Νανα*,

Σαβυρτιος, Τευταια, Τευτεά, Τεύτιος, Ζαμωνα, etc. Ces noms constituent presque plus d'un tiers de notre fonds, et, avec les noms communs, représentent un enrichissement de tout le patrimoine onomastique illyrien.

Dans le même temps, les noms fixent pour le moment aussi le profil et la place de l'anthroponymie dans la sphère de la langue et de la population illyrienne ainsi que des peuples environnants, et notamment ceux des Balkans. Ainsi pris, une suite de noms comme Daze, Bato, Epicade, Plator, Genth, Sura, Teuta, Apudia, Benet, Andène, Bojken, Itia, Tata, etc. qu'on retrouve dans notre pays et en Dalmatie, Pannonie, Norique, Vénétié, Messapie et dans d'autres régions, indépendamment de lieu de leur diffusion ou du centre de rayonnement, attestent des liens de langue, de civilisation et de compacité ethnique de la région illyrienne; d'autre noms comme Daze, Bato, Suro Epicade, Genth, Teuta, Teutio, Teutea, Agron, Epetin, Pladomen, Patron, Tata, etc. indiquent le voisinage avec les régions de la Dalmatie du S.-E., d'autres encore comme Plator, Daze, Lajd, Kailla parlent éloquemment des rapports avec le pays des Messapiens, tandis que plusieurs autres comme: Adamate, Amynta, Anna, Annia, Annyla, Apoita, Menoita, Phalacre, Klito et Léonad attestent des liens illyro-épirotes et illyro-macédoniens.

Un autre aspect du problème onomastique est aussi la question de la distribution géographique des noms illyriens dans notre pays. A ce sujet, à l'état actuel des recherches et dans l'attente d'une anthroponymie plus riche, il serait prématuré de fixer les zones qui ont été le noyau de tout nom. Comme on vient de le faire voir ci-dessus, chez nous les noms proviennent des villes littorales: Dyrrhachium, Apollonie, Skodra, Lissus et Bouthrotum, mais ils sont rencontrés également dans les régions à l'intérieur comme dans les villages de Petresh, à Kajon de la Dumré, dans la forteresse d'Irmaj, la ville d'Elbasan, à Kozare de Berat, à Kropisht de Vlore, et, encore plus profondément: à Kolesjan de Kukës, à Pogradec, dans la forteresse de Gradec et à Kamnik (Kolonje).

Considérant les noms au point de vue de leur valeur documentaire, il ressort qu'ils proviennent, jusqu'à présent, surtout des inscriptions grecques, et ils sont en général les plus anciens. Néanmoins, plusieurs noms gardent, sous la forme latine, leur continuité aussi dans les temps de la basse-latinité, et ce qui est plus, une suite de ces noms remontent à cette époque.

(Une traduction intégrale  
de l'article est dans les  
«Studia Albanica» 2, 1969).




Fig. 1-a




Fig. 1-b






Fig 2




Fig 3





Fig 4




Fig. 5






Fig. 6





Fig. 7




Fig. 8





Fig. 9




Fig. 10





Fig. 12



Fig. 11





Fig. 13




Fig. 14





Fig. 15




Fig 16






Fig. 17-a




Fig. 17-b






Fig. 18




Fig. 19






Fig. 20

